

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike)

Sesioni 1, Tema: Mjedisi i biznesit në Shqipëri – përditësimi i legjislacionit shqiptar dhe harmonizimi me Acquis e BE (Kapitulli 20)

e premte, 17 qershor 2022, 09:00 – 10:30

REKOMANDIME

Mjedisi i biznesit në Shqipëri karakterizohet nga disa elemente që e vështirësojnë punën dhe zhvillimin e biznesit në vend, siç janë barra administrative e kombinuar me procese të ndërlikuara që kërkojnë kohë dhe kosto për bizneset, konkurrueshmëri e ulët si dhe një nivel i lartë i informalitetit. Politika industriale dhe ajo e sipërmarrjes, përfshirë marrjen e masave për krijimin e një mjedisi për biznesin sa më gjithëpërfshirës që nxit zhvillimin, si dhe politikat e inovacionit dhe strategjitë për mbështetjen e biznesit me fokus Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) janë pjesë e Kapitullit 20 të Acquis së BE. Këto çështje u diskutuan gjatë aktivitetit të datës 17 qershor 2022, zhvilluar në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023 nga EMA dhe SFPA, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE). Gjatë diskutimit dolën në pah disa rekomandime e sugjerime, bazuar këto dhe në eksperiencën sllovaqe prezantuar nga ekspertja sllovaqe e pranishme në takim, përfaqësuese e Ministrisë së Financave në Sllovaki.

- *Gjatë procesit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Europian rekomandohet që të shmangët fenomeni që njihet si **gold plating** – ky proces lidhet me vendosjen e kritereve dhe standardeve më të larta se minimumi i vendosur nga vetë direktiva apo kuadri ligjor europian. Kjo mund të dëmtojë konkurrueshmërinë e biznesit vendas në krahasim me bizneset e vendeve të tjera që nuk kanë ligje dhe rregulla kaq strikte. Kështu që ky proces këshillohet të mos përdoret, ose nëse përdoret në raste shumë të veçanta duhet të ndiqet nga një analizë e detajuar dhe nga konsultime gjithëpërfshirëse me bizneset drejtpërdrejt të prekura*
- *Barra administrative dhe numri i lartë i ligjeve dhe rregullave që operatorët e biznesit duhet të ndjekin mund të kthehet në një problem për produktivitetin dhe funksionimin e tyre. Një shembull pozitiv për miratimin e ligjeve dhe rregulloreve për biznesin që vjen nga Sllovakia, por që ndiqet dhe nga shtete të tjera europiane është parimi **'one-in, two-out'**. Ky parim ka të bëjë me faktin që nëse një akt i ri ligjor do të duhet që të miratohet dhe kjo do të sjell kosto shtesë bizneseve atëherë duhet të merren masa që të amendohen apo përditësohen aktet e tjera ligjore ekzistuese me parimin të kursehet 2 Euro nga këto akte ekzistuese për një 1 Euro kosto që do të sjelli rregullorja e re. Kjo sugjerohet si një mundësi e mirë për të mos rritur kostot financiare të operatorëve të biznesit ndërkohë që duhet të plotësojnë kërkesat që vijnë nga këto ligje.*

- Masa të ndryshme lehtësuese duhet të merren në mbështetje të biznesit dhe sidomos të NVM-ve apo sipërmarrjeve të reja. Për të lehtësuar disa procese apo procedura masa që mund të merren janë – lehtësimi i afateve, orientimi ndaj përdorimit të shërbimeve elektronike (e-qeverisja), krijimi i mundësisë për trajnime online (e-learning) që të certifikohen në të njëjtën vlerë si trajnimet fizike etj.
- Konsultimi me komunitetin e biznesit është i nevojshëm, jo vetëm në fazën e konsultimit publik kur draft akti është përgatitur dhe publikuar por edhe në fazën fillestare ku sapo ka filluar puna për përgatitjen e një politike të tillë. Në këtë drejtim përfshirja e aktorëve të biznesit është në të gjithë fazat e procesit, dhe komentet dhe inputet e tyre do të ndikonin më shumë në procesin e hartimit e më pas të miratimit të draft akteve ligjore.
 - Përfshirja në këto konsultime duhet të realizohet duke identifikuar ato komunitete biznesi që janë drejtpërdrejt të ndikuara nga politika që po hartohet
 - Roli i tyre duhet të qartësohet që lidhet me miratimin ose jo të masave dhe politikave të prezantuara, duke ofruar sugjerime dhe zgjidhje
 - Këto konsultime dhe komente duhet që të merren në konsideratë dhe të vlerësohen gjatë RIA për biznesin dhe duhet të kenë në vëmendje sidomos si ndikon në konkurrencë dhe prodhimtari
- Këshillohet që komuniteti i biznesit të jetë aktiv dhe i përfshirë në politikëbërje jo vetëm kur ftohet nga Ministritë apo kur ka shpallje për konsultime publike, por duhet të jetë i përfshirë dhe në monitorimin e zbatimit të politikave dhe vlerësimit të ndikimit të tyre dhe të ndërhyjë me komente e sugjerime në çdo fazë të procesit. Kjo rrit mundësinë që të jenë dhe ata vetë nismëtarë për fillimin e punës për hartimin apo ndryshimin e një akti ligjor bazuar në kërkesat dhe nevojat e tyre.
- Rekomandohet që Produktiviteti dhe Konkurrueshmëria e biznesit duhet të ketë një vëmendje të veçantë dhe duhet të monitorohet, analizohet në mënyrë periodike dhe të realizohen dhe vlerësimet dhe raporte për këto dy kritere. Një rast suksesi nga Sllovakia është krijimi i një Këshilli me përgjegjësi kryesore këto dy elemente: konkurrueshmërinë dhe produktivitetin duke e lidhur me çështje të tjera si mjedisi i biznesit, inovacioni, tregtia, eficientia etj.
- Një praktikë pozitive për të vlerësuar ndikimin e politikave dhe ligjeve për biznesin është ai që njihet si vlerësimi ex post. Ky proces këshillohet që të ndiqet nga Ministria përgjegjëse për të vlerësuar nëse politika e ndërmarrë ka realizuar efektet e synuara apo ka lindur nevoja për amendime të saj apo dhe për shfuqizim. Vlerësimi ex post në rastin sllovak realizohet në këto dy mënyra:
 - Vlerësim i detajuar i aktit ligjor nga Ministria përgjegjëse. Rekomandohet një bashkëpunim dhe përfshirje dhe e aktorëve të prekur si komuniteti i biznesit, por edhe ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile apo të universitetit që mund të kontribuojnë me ekspertizën dhe përvojën e tyre.
 - Vlerësim sistematik i aktit ligjor ku krahasohen ndikimet e tij me ato që janë parashikuar në dokumentet gjatë procesit të hartimit (ex ante).